

V E N D I M
Nr. 339, datë 11.7.2002

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMEVE PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR KORRUPSIONIT, 2002-2003**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e planit të veprimeve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, 2002-2003, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen ministritë dhe institucionet qendrore, për zbatimin e këtij plani veprimesh.
3. Rekomandohen institucionet e pavarura, të përmendura në këtë plan veprimesh, të marrin masat përkatëse për zbatimin e tij.
4. Ngarkohen Ministri i Shtetit pranë Kryeministrit dhe Grupi i Monitorimit Antikorrupsion të ndjekin dhe të raportojnë zbatimin e planit të veprimeve.
5. Ministritë dhe institucionet shtetërore të përmendura në këtë plan, çdo gjashtë muaj, të raportojnë pranë Ministrit të Shtetit, pranë Kryeministrit, për realizimet respektive të planit të veprimeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko